

LIGJ
Nr.7619, datë 12.10.1992

PËR INSPEKTORATIN E KONTROLLIT TË PËRDORIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Inspektorati i Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike është organ ekzekutiv i paarmatosur dhe i specializuar për kontrollin e zbatimit të legjislacionit për përdorimin e energjisë elektrike në sektorin shtetëror e privat nga personat fizikë a juridikë, vendas ose të huaj me seli brenda a jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Shqipërisë.

Neni 2

Pranë Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare krijohet Inspektorati i Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike me degët e saj në rrethe, i cili varet nga ministri i Industrisë, Energjitikës dhe i Burimeve Minierave dhe jep llogari para tij.

Neni 3

Inspektorati i Kontrollit të Përdorimit të Përdorimit të Energjisë Elektrike ka këto detyra e të drejta:

- a) Të ushtrojë kontroll për mbrojtjen e rrjetit elektrik dhënë elementëve të tij nga ndërhyrjet e dëmtimet e kryera pa leje të ndërmarrjeve shitëse nga persona fizikë a juridikë vendas ose të huaj.
- b) Të ushtrojë kontroll për zbatimin drejt të legjislacionit dhe të rregullave të përdorimit të energjisë elektrike.
- c) Të kontrollojë lidhjen dhe zbatimin e kontratës së marrjes së energjisë elektrike.
- d) Të kontrollojë aparatet matëse të energjisë elektrike.
- dh) Të kontrollojë instalimet elektrike të përdoruesit.
- e) Të hyjë në banesa me pëlqimin e pronarit ose qiramarrësit për të kontrolluar furnizimin me energji elektrike deri te matësi i energjisë elektrike.
- ë) Të hyjë, me miratimin e prokurorit në çdo kohë, në banesa për të kontrolluar instalimet elektrike dhe përdoruesit e energjisë elektrike pas matësit, kur ka të dhëna se përvetësohet energjia elektrike.
- f) Të hyjë në çdo kohë në ndërmarrje, institucione, lokale e persona të tjerë juridikë për të kontrolluar instalimet, matësin dhe përdorimin e energjisë elektrike.

Neni 4

Hyrja e Inspektoratit të Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike në njësitë, repartet, ndërmarrjet dhe institucionet ushtarake, portet, aeroportet dhe doganat, bëhet me autorizim të titullarit të ministrisë përkatëse për ato objekte, në të cilat lejimi për të hyrë në to është kompetencë e tij, kurse për objekte të tjera me autorizim të komandantit të njësisë, repartit, drejtorit të ndërmarrjes dhe institucionit ushtarak.

Neni 5

Inspektori i Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike, kur gjatë ushtrimit të detyrës, konstaton dhe zbulon kryerjen e veprave penale nga persona të kontrolluar, vepron duke fiksuar provat materiale dhe sipas dispozitave në fuqi, bën kallëzim për ndjekje penale.

Neni 6

Cenimi ose dëmtimi i matësit të energjisë elektrike kur ai ndodhet brenda banesës ose jashtë saj, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur midis palëve, dhe lidhja e përdoruesit të energjisë elektrike me rrjetin elektrikpara aparatit matës nga persona të paaautorizuar nga ndërmarrja shitëse, kur këto shkelje nuk përbëjnë vepër penale, dënohen për kundravajtje administrative me gjobë nga 1000 deri në 10000 lekë, ndërsa kur këto veprime bëhen nga ndërmarrje dhe institucione shtetërore apo private, dënohen me gjobë nga 2 mijë deri 50 mijë lekë, si dhe me çdëmtimin nga kundravajtësi të dëmit të shkaktuar ndërmarrjes. Të drejtën e gjobës e kanë inspektorët e kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike.

Gjoba përbën titull ekzekutiv.

Neni 7

Gjoba deri në 2000 lekë është e formës së prerë. Kundër vendimit të dënimit me gjobë nga 2000 deri në 5000 lekë bëhet ankim me shkrim brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij te kryetari i Degës së Inspektoratit të Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike në rreth, akti i të cilit është i formës së prerë.

Kundër vendimit të dënimit të me gjobë mbi 5000 lekë bëhet ankim me shkrim brenda 5 ditëve, nga data e shpalljes së vendimit ose njoftimit të tij, tek kryetari i Inspektoratit të Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Me shpalljen e vendimeve të gjobave të formës së prerë bëhet menjëherë ndërprerja e furnizimit me energji elektrike.

Neni 8

Pagesa e gjobës bëhet brenda 10 ditëve nga dita e marrjes sëvendimit të formës së prerë. Për çdo ditë vonesë pas plotësimit të këtij afati deri në 1 muaj, gjoba shtohet 2 për qind mbi vleftën e saj. Pas këtij afati përdoret fleta e gjobës si titull ekzekutiv.

Rilidhja e energjisë elektrike bëhet nga ndërmarrja elektrike menjëherë pas paraqitjes së mandat pagesës së gjobës nga kundravajtësi.

Të ardhurat nga gjoba kalojnë në favor të buxhetit të shtetit, përveç 5% të vleftës së tyre, të cilat përdoren nga Inspektorati i Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike.

Neni 9

Inspektorati i Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike ka uniformën dhe shenjat dalluese që përcaktohen nga Ministria e Industrisë, Energjitikës dhe Burimeve Minerare në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik.

Punonjësit e Inspektoratit të Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike gëzojnë imunitet si punonjësit e policisë së rendit publik.

Inspektorët e kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike mbajnë përgjegjësi për humbjet e energjisë në zonën që mbulojnë.

Neni 10

Inspektorët e Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike pranohen shtetasit, që kanë kryer shërbimin ushtarak, kanë arsimin e lartë e të mesëm elektrik dhe një stazh pune në këtë profil jo më pak se 5 vjet si dhe të jenë të padënuar për krime ekonomike.

Neni 11

Inspektorati i Kontrollit të Përdorimit të Energjisë Elektrike, për kryerjen e detyrave të tij, bashkëpunon me Ministrinë e Rendit Publik dhe Policinë Financiare sipas udhëzimeve e marrëveshjeve të veçanta të nxjerra e nënshkruara nga këto organe.

Neni 12

Rregullat e hollësishme për zbatimin e këtij ligji caktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Aktet e tjera ligjore e nënligjore të nxjerra më parë dhe që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.331, datë 27.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha